



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇANI - OPSTINA DEÇANI



STATUTI

I KOMUNËS SË DEÇANIT

DEÇAN: 2010

Në bazë të nenit 12.1 dhe nenit 89 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Kuvendi I Komunës së Deçanit, në mbledhjen e vet të mbajtur me 04.05.2010, miraton:

STATUTIN E KOMUNËS SË DEÇANIT

Kapitulli I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

1.1 Statuti i Komunës është akti më i lartë juridik i Komunës së Deçanit të cilin e miraton Kuvendi i Komunës sipas procedurës së përcaktuar. / Në tekstin e mëtejme Statuti/.

1.2 Statuti i Komunës zbatohet brenda kufijve të Komunës së Deçanit.

Neni 2

Me këtë Statut rregullohet:

- Nocioni dhe kompetencat, statusi juridik, emblema dhe vulat, selia dhe festat e Komunës,
- Vendbanimet e Komunës,;
- Financat dhe pasuria e Komunës,
- Funksionimi dhe përgjegjësitë e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve,
- Kompetencat dhe përgjegjësitë e Kryetarit të Komunës,
- Organizimi i administratës komunale,
- Shërbim civil komunal, dhe,
- Transparenca, konsultimet me publikun dhe mekanizmat e pjesëmarrjes së qytetarëve.

Neni 3

3.1 Komuna e Deçanit është njësi themelore territoriale e vetëqeverisjes lokale, e përbërë nga komuniteti i qytetarëve ne territorin e përcaktuar me ligj të veçantë, e cila ushtron tërë pushtetin, i cili nuk është i rezervuar për institucionet qendrore.

3.2 Të gjitha organet e komunës kujdesen që qytetarët e komunës t'i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë pa dallim race, etnie, ngjyre, gjinie, gjuhe, religjioni, mendimi politik apo mendimi tjetër, prejardhjeje kombëtare apo sociale, pa dallim prone, lindje apo ndonjë statusi tje tër me qëllim që ata të gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta në shërbimet komunale të të gjitha niveleve.

3.3 Komuna i zbaton politikat dhe praktikat e saj për të mbështetur bashkëjetesën dhe paqen ndërmjet qytetarëve të komunës dhe për të krijuar kushte të përshtatshme që u mundësojnë të gjithë komuniteteve për t'i shprehur, ruajtur, zhvilluar identitetet e tyre etnike, kulturore, fetare dhe gjuhësore.

3.4 Qytetar i Komunës është çdo person i cili është banor i përhershëm i Republikës së Kosovës dhe që e ka vendbanimin e përhershëm në territorin e Komunës së Deçanit.

Neni 4

Komuna e Deçanit do të organizohet dhe udhëhiqet sipas këtij Statuti, ligj eve, rregulloreve dhe akteve të tjera normative që i miraton Kuvendi i komunës.

Neni 5

Përkufizimet

5.1 Fjala “komuna” i nënkupton të gjitha definicionet në vijim: Kuvendi i Komunës dhe cilido Komitet i tij, Kryetar, apo drejtorate dhe çdo person apo organizatë që vepron në emër të personave të lartpërmendur;

5.2 “parimi i subsidiaritetit” don të thotë që çështjet publike realizohen, sa më shumë që të jetë e mundur, në interes të qytetarëve nga niveli më i ulët i qeverisë që është në gjendje të ofrojë shërbime efikase.

5.3 “komunitet” don të thotë grupë komuniteti që i përkasin një grupi të njëjtë etnik, fetar apo gjuhësor.

5.4 Shprehja “Aktet e komunës” nënkupton vendimet dhe aktet tjera të nxjerrura nga komuna të cilat rezultojnë me efektet legale për një apo më shumë persona apo organizata.

Neni 6

Për të gjitha aktet e miratuara nga komuna, personit apo organizatës së cilës i drejtohen këto masa, do t’i kumtohet arsyetimi me shkrim në kohën kur ato ndërmerren. Në raste emergjente, arsyet do të jepen gojarisht dhe do të kumtohen me shkrim sa më shpejt të jetë e mundur. Parimi i besueshmërisë do të mbizotëroj në çdo rast që të ndërmerren masat.

Neni 7

Personi apo organizata të cilës i drejtohen masat, do jenë të informuar me shkrim rreth çdo të drejte për ankesë dhe procedure interno të shqyrtimit që mund të ekzistojë kur është fjala për masat formale. Këto informata do të jepen në kohën kur të ndërmerren masat formale, apo në raste të emergjencës, sa më shpejt të jetë mundur pasi të ndërmerren masat.

Neni 8

Statusi Juridik

Komuna ka cilësinë e personit juridik. Si person juridik, komuna ka kompetenca, në mes tjerash, që:

- a) të padisë dhe të paditet në gjykata;
- b) të posedojë, dhe të menaxhojë pasurinë;
- c) mund të jetë pronare apo bashkëpronare e ndonjë kompanie që është në interes të komunës në raport me qytetarët;
- ç) të lidhë kontrata;
- d) të kompletoj stafin me numër të caktuar të shërbyesve civil dhe
- dh) të angazhohet në aktivitete të tjera që janë të domosdoshme për realizimin e përgjegjësi të saj.

Neni 9

Emblema dhe vulat

9.1 Komuna identifikohet me emblemën e vet të përcaktuar me vendim të posaçëm të Kuvendit Komunal, i cili duhet të jetë në harmoni me dispozitat ligjore në fuqi.

9.2 Komuna ka vulën e vet të rrumbullakët me tekst: Republika e Kosovës - Komuna Deçan (në gjuhën Shqipe, dhe Serbe). Në mes të vulës është Stema e Republikës së Kosovës dhe numrat rendor sipas radhitjes së drejtorateve Komunale nga neni 61 i këtij Statuti.

9.3 Komuna ka vulën katrore me të njëjtin tekst si në alinenë paraprake, me vendin e zbrazët për evidencën e numrit rendor dhe datës, muajit dhe vitit, e njëjta përdoret për evidentimin e shkresave zyrtare.

9.4 Komuna mund të përdori vulën e vet me Stemen e Komunës vetëm në ato akte për të cilat nuk është e obliguar të vendosi Stemen e Republikës së Kosovës sipas dispozitave të nenit 12 të Ligjit

për Përdorimin e Simboleve Shtetërore të Kosovës.

Neni 10

Selia e komunës është: Sheshi “Mentor Tolaj” p.n Deçan

Neni 11

Festa e komunës së Deçanit është 16 Qershori dita e çlirimit.

Neni 12

Gjuhët

12.1 Përdorimi i gjuhëve në Komunë rregullohet në pajtim me Ligjin në fuqi për përdorimin e gjuhëve.

12.2 Kuvendi i Komunës miraton rregullore komunale të detajuara për përdorimin e gjuhëve brenda territorit të Komunës, siç përcaktohet me ligjin për përdorimin e gjuhëve.

Kompetencat dhe përgjegjësit e komunës

Neni 13

Komuna i ushtron kompetencat e saj sipas parimit të sub sidiaritetit.

Neni 14

Komuna brenda territorit të saj dhe në harmoni me ligjet e zbatueshme, ushtron kompetenca të plota dhe ekskluzive të interesit lokal në fushat vijuese:

- 1) zhvillimin lokal ekonomik;
- 2) planifikimin urban dhe rural;
- 3) shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin;
- 4) zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit;
- 5) mbrojtjen e mjedisit,
- 6) ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal dhe skemave të nxehtësisë lokale;
- 7) përgjigje ndaj rasteve emergjente lokale dhe zjarrfikjen;
- 8) ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit;
- 9) promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut
- 10) ofrimin e përkujdesit publik primar shëndetësor;
- 11) ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, siç është përkujdesi për të cënueshmit, strehimin familjar, përkujdesin fëmijor, përkujdesin për të moshuarit, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave përkujdesëse, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e profesionistëve të mirëqenies sociale;
- 12) banimin publik;
- 13) shëndetësinë publike;
- 14) licencimin e shërbimeve publike dhe objekteve, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me argëtimin, aktivitete kulturore dhe të lira, ushqimin, strehimin, tregjet, shitësit në rrugë, transportimin lokal publik dhe taksitë;
- 15) emërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;
- 16) ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve, hapësirës publike dhe varrezave;
- 17) turizmit;

- 18) aktivitetet kulturore, sportive dhe aktivitete tjera të lira;
- 19) Aktivitetet e rinis;
- 20) Avancimin e vlerave qytetare;
- 21) Organizimin e panairove dhe tregj eve,
- 22) Cakton ndërmarrjet publike ne interes të posaçëm për komunën,
- 23) çdo çështje që nuk është përjashtuar shprehimisht nga kompetenca e komunës, apo që nuk i është përcaktuar një autoriteti tjetër;

Neni 15

15.1 Komuna gjithashtu është përgjegjëse për zbatimin e kompetencave të deleguara ne nga institucionet qendrore si:

- shënimet kadastrale,
- regjistrimin civil;
- regjistrimin e votuesve;
- regjistrimin e bizneseve dhe licencimin;
- distribuirimin e pagesave te ndihmës sociale (me përjashtim te pensioneve);
- mbrojtjen e pyjeve ne territorin e komunës duke përfshi edhe shenjen e licencave për prerjen e drunjtëve ne bazë te rregullave te miratuara nga Qeveria;
- kompetenca tjera qe i delegohen nga autoritetet qendrore ne pajtim me ligjin.

15.2 Fondet për këto qëllime i sigurohen komunës nga Qeveria.

Neni 16

16.1 Brenda fushës se kompetencave qe ka, komuna ka te drejt të bashkëpunoj dhe të krijoj partneritet me komuna tjera të Republikës së Kosovës dhe me organe te huaja të vetëqeverisjes lokale, për kryerjen e funksioneve me interes të përbashkët në pajtim me ligjin dhe me parimet e Kartës Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale.

16.2 Kompetencat nga neni 24 i këtij Statuti nuk mund të ushtrohen përmes partneriteteve komunale.

16.3 Aktivitetet e partneriteti financohen përmes buxhetit te komunave ne partneritet.

16.4 Komunat ne partneritet mund te themelojnë organe vendimmarrëse me përfaqësues të emëruar nga kuvendet komunale, te punësojnë dhe shkarkojnë personel administrativ dhe këshillëdhënës dhe te marrin vendime mbi nevojat për financim dhe nevoja tjera operationale të partneritetit.

Kapitulli II **VENDBANIMET E KOMUNËS**

Neni 17

17.1 Komuna ka territorin e vet gjeografik të përcaktuar me Ligjin për kufijtë administrativ të komunave dhe kufiri mund te ndryshohet vetëm ne përputhje me ketë ligj.

17.2 Territori i komunë së Deçanit përfshinë këto vendbanime:

1. Baballoq,
2. Beleg,
3. Belle,
4. Carrabreg i Epërm,
5. Carrabreg i Ulët,
6. Dashinoc,
7. Deçan,
8. Drenoc,
9. Dubovik,
10. Dubravë,
11. Glllogjan
12. Gramaçel,
13. Hulaj,
14. Irzniq,
15. Isniq,
16. Kodrali,
17. Lëbushë,
18. Lumbardh,
19. Lloqan,
20. Llukë e Epërme,
21. Llukë e Ulët,
22. Maznik,
23. Papiq,
24. Pobërgjë,
25. Pozhar,
26. Prapaqan,
27. Prekolluk,
28. Prilep,
29. Rastavicë,
30. Ratish i Epërm,
31. Ratish i Ulët,
32. Sllup,
33. Strellc i Epërm,
34. Strellc i Ulët,
35. Shaptej,
36. Voksh,
37. Vranoc i Vogël,

17.3 Pos lokaliteteve të lartshënuara , me vendimin e Kuvendit dhe në përputhje me planin hapësinor të Komunës mund të parashihen se në përbërjen e qytetit dhe fshatrave hyjnë lagjet, gjegjësisht ndërtesat e banimit të ngritura jashtë tyre si vendbanime periferike.

Neni 18

18.1 Komuna mund të bëjë marrëveshje me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane brenda territorit të vet për të siguruar përmbushjen e të gjitha nevojave të të gjithë qytetarëve të komunës. Këto marrëveshje bëhen në pajtim me Udhëzimet që i lëshon Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

18.2 Me aprovimin e komunës, fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, vetë apo në mënyrë të kombinuar, mund të kryejnë aktivitete që bëjnë pjesë në përgjegjësitë dhe në kompetencat e komunës. Në këtë rast, komuna ofron burime të mjaftueshme për fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane.

18.3 Statuti dhe rregulloret komunale e përcaktojnë formën e bashkëpunimit ndërmjet komunës dhe fshatrave, vendbanimeve dhe lagj eve urbane dhe fushën e punës dhe organizimin e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane. Të gjitha fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane e respektojnë ligjin në fuqi gjatë kryerjes së aktiviteteve sipas marrëveshjes me komunën.

Neni 19

19.1 Komuna në disa lokalitete ka Zyrat e Gjendjes Civile , me qëllim të kryerjes së shërbimeve të parapara me dispozitat ligj ore, Statutin Komunal dhe Vendimet e Kuvendit Komunal.

19.2 Në territorin e Komunës janë të themeluara këto Zyra të Gjendjes Civile:

I Zyra qendrore e Gjendjes Civile në Deçan, e cila përfshinë fshatrat:

- 1 .Deçan
- 2.Carrabreg i Ulët
- 3.Carrabreg i Epërm
- 4.Llukë e Epërme,
- 5.Beleg.
- 6.Prilep
- 7.Rastavicë,

II Zyra e Gjendjes Civile në Drenoc, e cila përfshinë

- fshatrat:**
- 1 .Drenoc,
 - 2.Voksh,
 - 3.Lloçan,
 - 4.Hulaj
 - 5.Sllup,
 - 6.Pobërgj,

III Zyra e Gjendjes Civile në Irzniq, e cila përfshinë fshatrat:

- 1 .Irzniq
- 2.Kodralli,
- 3.Pozhar,
- 4.Llukë e Ulët,
- 5.Lumbardh,
- 6.Dashinoc,
- 7.Vranoc i Vogël,
- 8.Maznik,
- 9.Ratishë e Ulët,
- 10.Ratishë e Epërme,
- 11 .Glllogjan,
12. Shaptej,

- 13.Dubravë,
- 14.Gramoçel,
- 15.Baballoq,
- 16.Prekolluk,

IV Zyra e Gjendjes Civile në Strelc e cila përfshinë këto fshatra:

1. Strelc i Epërm,
- 2.Strelc i Ulët,
- 3 .Lëbushë,
- 4.Belle.

V Zyra e Gjendjes Civile në Isniq e cila përfshinë këto fshatra:

- 1 .Isniq,
- 2.Prapaçan,
- 3 .Dubovik,
- 4.Papiq.

19.3 Kuvendi i Komunës me Vendim të veçantë mund të themeloj Zyra të Gjendjes Civile edhe për lokalitete të tjera.

Neni 20

20.1 Komuna mund të bëjë marrëveshje me organizatat jofitimprurëse nëse ato ofrojnë shërbime në kuadër të kompetencave të komunës.

20.2 Format e bashkëpunimit do të përcaktohet me rregullore të veçantë.

Kapitulli III

PASURIA DHE FINANCAT E KOMUNËS

Neni 21

Pasuria e komunës

21.1 Komuna ka të drejtë të posedojë dhe menaxhojë me pasuri të luajtshme dhe të pa luajtshme.

21.2 Komuna ka të drejtë të japë me qira dhe të shesë pasurinë e luajtshme dhe të pa luajtshme sipas ligjit, me përjashtim të shitjes së tokës e cila rregullohet me ligj të posaçëm.

21.3 Komuna mban dhe udhëheq regjistrin e pronës së luajtshme dhe të pa luajtshme që e ka në shfrytëzim dhe posedim.

Neni 22

Financat komunale

22.1 Komuna ka Buxhetin dhe të hyrat financiare, për financimin e aktiviteteve të saj. **22.2** Buxheti dhe financat komunale rregullohen me Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal dhe aktet tjera.

22.3 Buxheti komunal përbëhet prej të hyrave vetanake, grandeve nga Qeveria e Republikës së Kosovës, donacioneve dhe të hyrave të tjera.

22.4 Buxheti i komunës duhet të jetë i balancuar, i përgatitur në mënyrë transparente dhe i bazuar në kritere objektive.

22.5 Buxheti duhet te përmbaj planin për aktivitete dhe udhëheqje ekonomike brenda vitit fiskal dhe duhet te përfshij te gjitha parashikimet e te hyrave, shpenzimeve kapitale dhe ato te përditshme të komunës.

22.6 Një pjesë e fondeve te transferuara munde te ndahen për veprimtarit specifike te përcaktuara ne nenin 14 të Statutit.

22.7 Buxheti i komunës miratohet me 2/3 e votave të këshilltarëve të zgjedhur të Kuvendit Komunal..

22.8 Komuna mund te mbledh te hyra nga:

- a) Licencat dhe pagesat qe i cakton
- b) nga te ardhurat dhe pasuria e komunës
- c) gjobat apo përqindja e gjobave.

22.9 Viti fiskal i komunës fillon me një Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor.

22.10 Raporti vjetor pas përfundimit të çdo viti fiskal i prezantohet Kuvendit Komunal më së largu deri më 30 Maj te vitit vijues.

22.11 Komuna obligohet qe raportet e auditimeve financiare te ja prezantoj Kuvendit Komunal.

Neni 23

Auditimi i brendshëm

23.1 Komunat kanë obligim ligjor për të bërë auditim të brendshëm, së paku një herë në vit.

23.2 Komuna ka të drejtë për të themeluar një shërbim autonom të auditimit në komunë, apo për të siguruar auditim të brendshëm nga një firmë e akredituar e auditimit në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Kosovës.

Neni 24

Shërbimet komunale që ofrohen nga ndërmarrjet komunale

24.1 Në rastet ku shërbimet komunale ofrohen nga ndërmarrjet komunale, ato ndërmarrje duhet t'ia dorëzojnë buxhetet e tyre kuvendit të komunës për miratim. Propozimet buxhetore duhet të përfshijnë strukturën e propozuar të tarifës për ofrimin e shërbimeve dhe duhet të dorëzohen para datës 15 nëntor të vitit të ardhshëm fiskal.

24.2 Në rastet kur një ndërmarrje ofron shërbime publike komunale për më shumë se një komunë, komunat themelojnë bord të përbashkët menaxhues për mbikëqyrje të aktiviteteve të ndërmarrjes.

Kapitulli: IV

FUNKSIONIMI DHE PËRGJEGJËSITË E KUVENDIT TË KOMUNËS DHE KOMITETEVE

Neni 25

Kuvendi i Komunës së Deçanit në seancat e veta shqyrton dhe vendos për:

1. Aprovimin e Statutit dhe Rregullores së punës, rregulloreve komunale dhe miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre,
2. Aprovimin e Buxhetit të Komunës së Deçanit dhe planeve investuese,
3. Aprovimin e çështjeve tjera të cilat sipas Ligjit dhe Rregulloreve i janë lënë në kompetencë të Kuvendit të Komunës,
4. Aprovimin e planit vjetor dhe raportit vjetor të punës.
5. Aprovimin e Planit zhvillimor komunal, Planit zhvillimor urban dhe planeve rregulluese urbane,

6. Vendos për emërimin dhe rrimërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;
7. Merr Vendime dhe nxjerrë Akte tjera të interesit të përgjithshëm,
8. Zgjedh Kryesuesin e Kuvendit Komunal,
9. Formon Komitete (Komisione) për funksionimin e pushtetit lokal dhe bën emërimin e anëtarëve te tyre,
10. Aprovon nivelin e tarifave dhe ngarkesave;
11. Në rast nevoje shkarkon kryesuesin e Kuvendit dhe anëtarët e Komiteteve,
12. Shqyrton raportet periodike dhe vjetore të punës së Ekzekutivit,
13. Themelon organet e administratës dhe shërbimet tjera komunale profesionale , ndërmarrje – kompani që kryejnë punë me interes për Komunën dhe përcakton bazat e organizimit dhe fushëveprimin e tyre të punës,
14. Emëron anëtarët e Bordit mbikëqyrës në ndërmarrjet publike të cilat i themelon.
15. Merr Vendime mbi shpalljen e referendumit Komunal,
16. Jep mendimin mbi ndryshimin e kufijve të Komunës,
17. Ushtron mbikëqyrjen mbi ndërmarrjet publike komunale te komunës se Deçanit , përmes Bordeve mbikëqyrëse si dhe shqyrtimit dhe aprovimit të buxhetit të tyre dhe raporteve financiare.
18. Vendos për krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të komunës, në pajtim me ligjin në fuqi;
19. Vendos mbi ndarjen e titullit “ Qytetar nderi “i Komunës.
20. Vendosë mbi themelimin e Fondacionit për ndarjen e Çmimeve të Veçanta personave të merituar.
21. Përcakton dhe themelon bashkësitë lokale dhe Zyrat e Gjendjes Civile,
22. Vendos për arritjen e marrëveshjeve ndërkomunale dhe brenda komunale (me fshatra, vendbanime, lagje dhe bashkësi lokale);
23. Vendos mbi lidhjen e marrëveshjeve dhe Memorandumeve Bashkëpunimi e Mirëkuptimi me komunat dhe qytetet jashtë Republikës së Kosovës.
24. Bien vendim për kompensimin për këshilltarët e zgjedhur.
25. merr vendimeve për t’u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës;
26. Kryen edhe funksione tjera te cilat i lejohen me ligj.

Neni 26

26.1 Kuvendi Komunal mund te delegon pushtetin për te marr vendime një komiteti ose Kryetarit te komunës.

26.2 Delegimi mund te revokohet ne çdo kohë.

26.3 Kuvendi i komunës nuk mund t’i delegon përgjegjësitë e tij lidhur me marrjen e vendimeve për:

- a) statutin dhe Rregulloren e punës, rregulloret komunale dhe miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre
- b) miratimin e buxhetit dhe planeve investuese;
- c) miratimin e çështj eve të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për kuvendin sipas statutit apo rregullores së punës;
- d) planin vjetor të punës dhe raportin vjetor;

dh) themelimin e komisioneve të kërkuara sipas Ligji për Vetëqeverisjen Lokale;

e) zgjedhjen e kryesuesit të kuvendit;

ë) niveli i tarifave dhe ngarkesave;

I) krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të komunës, në pajtim me

ligjin në fuqi;

g) emërimin dhe rrimërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;

gj) arritjen e marrëveshjeve ndërkomunale dhe brenda komunale;

h) marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës; dhe

i) Dhe përgjegjësitë tjera që me ligj janë në kompetencë ekskluzive vetëm të Kuvendit .

Neni 27

Aktet e organeve komunale

27.1 Kuvendi i komunës dhe kryetari kanë të drejtë të miratojnë akte dhe të ndërmarrin masa për zbatimin e tyre brenda fushës së kompetencave të tyre.

Aktet e kuvendit të komunës përfshijnë:

- 1) Statutin e komunës;
- 2) Rregulloren e punës;
- 3) Rregulloret komunale dhe
- 4) Çdo akt tjetër të nevojshëm për funksionimin efikas të komunës.

26.2 Të gjitha aktet komunale duhet të jenë në përputhje me sistemin kushtetues dhe ligjor të Republikës së Kosovës.

27.3 Kryetari i komunës ka të drejtë të nxjerr urdhëresa dhe vendime brenda fushës së kompetencave të tij/saj.

Neni 28

Organet e Komunës

Organet komunale të komunës së Deçanit janë:

- Kuvendi i Komunës- organi më i lartë i Komunës dhe -
- Kryetari i Komunës- organi më i lartë ekzekutiv i Komunës

Neni 29

Kuvendi Komunal

29.1 Kuvendi i Komunës së Deçanit është organi më i lartë i komunës i cili zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët në pajtim me Ligjin mbi zgjedhjet lokale.

29.2 Kuvendin e përbëjnë 27 anëtar të zgjedhur drejtpërdrejt me votën e popullit.

29.3 Të gjithë qytetarët e komunës mund të kandidohen në kuvendin e komunës, me kusht që ata t'i plotësojnë kushtet e parapara në Ligjin mbi zgjedhjet lokale.

Neni 30

30.1 Mandati i anëtarëve të kuvendit të komunës është katër vite.

30.2 Anëtari i kuvendit të komunës pushon të jetë anëtar:

- a) me rastin e përfundimit të mandatit të tij;
- b) nëse ai/ajo ndërron vendbanimin ku është zgjedhur;
- c) nëse anëtari ia paraqet kryetarit të komunës dorëheqjen me shkrim nga posti i tij;
- d) nëse anëtari ka qenë i dënuar për ndonjë veprë penale dhe është lëshuar urdhri për burgim për gjashtë ose më shumë muaj;

dh) nëse anëtari nuk merr pjesë tre (3) muaj rresht në mbledhjet e kuvendit të komunës pa arsye;

e) nëse ligji në fuqi, apo ndonjë ligj tjetër i zbatueshëm s'kualifikon apo e konsideron të papërzgjedhshëm.

30.3 Anëtari i kuvendit të komunës në të njëjtën kohë nuk mund të jetë deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Neni 31

Anëtarit të zgjedhur të Kuvendit të komunës së Deçanit , të cilit i pushon mandati për çfarëdo arsyeje, zëvendësohet nga kandidati pasues në Listën e partisë politike përkatëse nga zgjedhjet e fundit në përputhje me ligjin mbi zgjedhjet.

Neni 32

32.1 Të gjithë anëtarët e kuvendit të komunës kanë të drejta dhe mundësi të barabarta të marrin pjesë plotësisht në punimet e kuvendit.

32.2 Kuvendi i komunës siguron që këto të drejta dhe mundësi të parashikohen në rregulloren e tij të punës

32.3 Anëtari i kuvendit të komunës ka të drejtë të kërkojë informacione lidhur me çështjet komunale nga kryetari, apo nga kryesuesi i kuvendit dhe kryesuesit e komiteteve. Kërkesa shqyrtohet në pajtim me procedurat që do të përcaktohen me Rregulloren e punës..

32.4 Anëtari i kuvendit të komunës mund të dorëzojë vërejtje me shkrim, të cilat i bashkëngjiten procesverbalit.

32.5 Anëtari i kuvendit të komunës mund t'iu drejtohet të pranishmëve në cilindo komision të kuvendit të komunës anëtar i të cilit nuk është, por nuk mund të votojë. Ai apo ajo mund t'i propozojë kryesuesit të komitetit që të diskutohet ndonjë çështje që është përgjegjësi e komitetit.

32.6 Anëtari i kuvendit të komunës mund të kërkojë nga kryetari informacione që janë të nevojshme për punën e tij si këshilltar. Nëse nuk është i kënaqur me përgjigjen, ai apo ajo mund ta ngritë çështjen në kuvendin e komunës.

32.7 Çdo anëtarë i Kuvendit ka të drejtë të kërkojë informatë për shqyrtim të çështjeve të caktuara në lidhje me punën e Kryetarit dhe udhëheqësve të tjerë të komunës të emëruar nga Kuvendi.

32.8 Kërkesa për informatë i paraqitet me shkrim Kuvendit të komunës me pyetjet të cilat duhet të shqyrtohen dhe duhet të jenë të formuluarat qartë dhe të arsyeshme.

32.9 Anëtarët e kuvendit të komunës detyrohen të marrin pjesë në të gjitha mbledhjet e kuvendit, të thirrura në mënyrë të duhur në komisionet ku ata janë anëtarë, përveç rasteve kur ekzistojnë arsye të justifikueshme për mungesën e tyre.

Konfliktet e interesave të anëtarëve

Neni 33

33.1 Anëtari i Kuvendit Komunal apo i Komitetit nuk mund të marr pjesë në marrjen e vendimeve dhe në procedurat administrative që kanë të bëjnë me cilëndo çështje në të cilën ai/ajo apo ndonjë anëtar i afërt i familjes së tij, ka interes personal apo material.

33.2 Anëtarët që kanë konflikte interesash as nuk flasin e as nuk votojnë lidhur me atë çështje në fjalë në çdo mbledhje si dhe do të tërhiqen nga salla në të cilën mbahet mbledhja derisa ajo çështje në fjalë është në diskutim e sipër.

33.3 Në momentin kur anëtari për shkak të konfliktit të interesit largohet nga mbledhja e Kuvendit , gjatë kohës së mungesës së tij , kuorumi i mbledhjes medoemos duhet të ekzistoj.

33.4 Çdo këshilltar duhet t'i çfaqë konfliktet e interesave që lindin në çdo njërin prej mbledhjeve në të cilën është i pranishëm.

33.5 Çdo këshilltar mund të ofroj informacione që janë në interes të këshilltarit tjetër.

33.6 Çdo anëtar mund të tërhiqet vullnetarisht nga procesi i marrjes së vendimeve dhe nga procedurat administrative, nëse konsideron se ato mund të qojnë deri të konflikti i interesave.

33.7 Anëtarët e Kuvendit Komunal nuk mund të punësohen nga komuna në asnjë pozitë udhëheqëse.

33.8 Para mbledhjes së parë të Kuvendit Komunal, anëtarët e Kuvendit duhet të i regjistrojnë deklaratat e plota dhe të hapura rreth interesave të tyre financiare dhe këtë regjistër e mban Drejtorati i Administratës dhe personelit. Anëtarët duhet të shënojnë çdo ndërrim të gjendjes së tyre financiare posa ato të ndodhin.

33.9 Në rast se ndonjë konflikt potencial i interesave zbulohet pasi të jetë marrë ndonjë vendim por para se ai të zbatohet, ai vendim pezullohet dhe se çështja në fjalë hetohet. Në rast se konstatohet se ekziston konflikti i interesave, vendimi anulohet dhe revokohet si dhe votohet sërish.

Mbledhja e parë e Kuvendit dhe deklaratat solemne e anëtarëve

Neni 34

34.1 Kuvendi Komunal duhet ta mbajë mbledhjen e parë inauguruese Brenda 15 ditëve nga dita e certifikimit të rezultateve zgjedhore.

34.2 Mbledhjen inauguruese të kuvendit të komunës e thërret kryetari i komunës (nëse është zgjedh), në të kundërtën atë e thërret anëtari më i vjetër. Nëse edhe anëtari më i vjetër nuk e thërret mbledhjen inauguruese ajo caktohet me iniciativën e shumicës së anëtarëve të kuvendit.

34.3 Anëtari më i vjetër i Asamblesë komunale do të kryesoj mbledhjen deri sa të zgjidhet Kryesuesi i Kuvendit.

34.4 Mandati i çdo anëtari të kuvendit të komunës verifikohet nga komisioni për verifikimin e mandateve që themelohet nga kuvendi i komunës, para nënshkrimit të mandatit nga secili këshilltar.

34.5 Anëtarët e Kuvendit duhet ta nënshkruajnë betimin solemn si në vijim:

“BETOHEM (DEKLAROH SOLEMNISHT) SE DO T’I KRYEJ MË NDER, ME BESNIKËRI, PA ANIME E ME NDËRGJEGJE DHE SIPAS LIGJIT DETYRAT DHE DO T’I USHTROJ AUTORIZIMET E MIA SI KËSHILLTAR I KUVENDIT KOMUNAL TË DEÇANIT NË MËNYRË QË TË SIGUROHEN KUSHTET PËR JETË TË QETË PËR TË GJITHË.”

34.6 Anëtarët e kuvendit të komunës, të cilët nuk e nënshkruajnë betimin ose mandatin në pajtim me paragrafët 4 dhe 5 të këtij neni brenda një muaji pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve, pushojnë së qeni anëtarë.

Neni 35

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

35.1 Kuvendi i komunës e zgjedh kryesuesin e kuvendit të komunës nga radhët e anëtarëve.

35.2 Kryesuesi i kuvendit të komunës zgjidhet për një mandat të njëjtë sikurse anëtarët e kuvendit;

35.3 Votimi në të gjitha zgjedhjet për kryesues të kuvendit të komunës është me vota të fshehta.

35.4 Për t'u zgjedhur në votimin e parë, kandidati duhet të marrë më shumë se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të zgjedhur.

35.5 Në rast se në votimin e parë asnjëri prej kandidatëve nuk e siguron shumicën e kërkuar, atëherë dy kandidatët me numrin më të madh të votave shkojnë në votimin e dytë. Kandidati që merr më shumë se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të zgjedhur do të zgjidhet kryesues i kuvendit të komunës.

35.6 Nëse vendi i kryesuesit lirohet, Kuvendi komunal bënë zgjedhjen e tij jo më larg se 30 ditë pas lirimit të vendit sipas procedurës së paraparë.

Neni 36

Rregullorja e punës

36.1 Kuvendi i Komunës miraton Rregulloren e punës.

36.2 Me Rregulloren e punës saktësohen procedurat për thirrjen, udhëheqjen, ecurinë e mbajtjes së mbledhjeve, procesverbalin dhe procedurat e votimit.

36.3 Rregullorja e punës ose ndryshimet e saj konsiderohen të miratuara kur për këtë votojnë më shumë se gjysma e anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

Neni 37

Kuorumi dhe mbledhjet

37.1 Kuorumi për të gjitha mbledhjet e Kuvendit komunal dhe komitetet e tij përbëhet nga më shumë se gjysma e anëtarëve të pranishëm në mbledhje me të drejtë pjesëmarrje dhe votimi.

37.2 Kuorumi duhet të verifikohet para se të merret çfarëdo vendimi në kuvend apo komitete.

37.3 Në të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe të Komiteteve të tij, të gjithë këshilltarët duke përfshi edhe kryesuesin kanë nga një votë. Kryesuesi i Kuvendit Komunal, në rast të numrit të barabartë të votave "Për" ose "Kundër" ndonjë propozimi ka një votë shtesë.

37.4 Kuvendi i Komunës dhe Komitetet marrin vendime me vota të hapura, përveç nëse kërkohet ndryshe me ligje, me këtë Statut dhe Rregulloren e punës.

37.5 Vendimet e Kuvendit të Komunës dhe të Komiteteve të tij merren me votimin e shumicës së anëtarëve prezent, përveç nëse kërkohet ndryshe me ligje dhe me këtë Statut.

37.6 Abstenimet regjistrohen me qellim të themelimit të kuorunit, por nuk merren parasysh në rezultatet e votimit.

Neni 38

38.1 Mbledhjet e Kuvendit i konvokon dhe i kryeson Kryesuesi i kuvendit.

38.2 Kuvendi mbledhet sa here që është e paraparë me Rregulloren për Punë të Kuvendit, por që së paku Kuvendi duhet të mbajë dhjetë (10) mbledhje brenda vitit. Pesë prej tyre duhet të mbahen gjatë gjashtëmujorit të parë.

38.3 Njoftimi dhe materialet e mbledhjes bëhen duke respektuar Ligjin mbi Gjuhët. I njëjti njoftim shpallet edhe për publikun dhe i dërgohet edhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

38.4 Kuvendi i Komunës dhe komitetet në fillim të çdo viti, me vendim të veçantë do të caktojnë orarin vjetor të mbajtjes së mbledhjeve të rregullta për vitin kalendarik.

38.5 Varësisht nga kushtet dhe rrethanat mund të ndryshojë data e mbajtjes së mbledhjeve nga data e paraparë.

38.6 Mbledhjet e Kuvendit të komunës gjithashtu mund të thirren me kërkesën e një të katërtës (çereku) të të gjithë anëtarëve të zgjedhur, ose nga një Komitetet i Kuvendit.

38.7 Anëtarët e Kuvendit duhet të njoftohen më së paku shtatë ditë pune para çfarëdo mbledhje të Kuvendit Ata duhet patjetër të njoftohen për kohën, datën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes si dhe me rendin e punës së asaj mbledhje.

38.8 Rendi i ditës për takimin e kuvendit të komunës caktohet nga kryesuesi i kuvendit të komunës në marrëveshje me Kryetarin e Komunës.

38.9 Anëtari i kuvendit të komunës mund të kërkojë shtimin e një pikë në rendin e ditës gjatë seancës së rregullt të kuvendit të komunës, nëse çështja që kërkohet të përfshihet në rend të ditës është çështje urgjente me rëndësi publike dhe kërkesa e tillë mund të miratohet apo refuzohet me votën e shumicës.

38.10 Rregullorja e punës së kuvendit të komunës parasheh dispozita tjera për përgatitjen, miratimin dhe ndryshimin e rendit të ditës.

38.11 Njoftimet publike për këto mbledhje duhet po ashtu të shpallen në të njëjtën kohë.

38.12 Takimet e Kuvendit të komunës dhe të gjitha komisioneve të tij janë të hapura për publikun dhe pjesëmarrja e publikut ne takimet e Kuvendit dhe komisioneve te tij rregullohet me Rregulloren e punës.

38.13 Kuvendi i komunës, apo komiteti, me votën e shumicës, mund të vendosë për përjashtimin e publikut nga i tërë takimi, apo nga një pjesë e tij, në rastet kur:

a) mendohet se mbajtja e një takimi të hapur mund të shpie deri te një çrregullim publik apo dhunë;

b) takimi i hapur kërcënon të zbulojë informacione [dhe dokumente], të cilat janë të klasifikuara si të besueshëm sipas Ligjit mbi qasjen në dokumentet zyrtare;

c) kërcënon të zbulojë informacione të ndjeshme personale apo komerciale; ose

d) informacione lidhur më procedurat gjyqësore të tanishme apo të ardhshme.

38.14 Në rastet e tilla, kuvendi i komunës njofton për vendimin e marrë.

38.15 Në të gjitha mbledhjet e Kuvendit komunal dhe të komiteteve mbahet procesverbali. Ai mbahet në pajtim me ligjin për përdorimin e gjuhëve dhe aprovohet në takimin vijues.

38.16 Procesverbali duhet te përmbaj emrat e këshilltarëve te pranishëm dhe anëtarëve te ftuar, rendin e ditës, esencën e diskutimit, rezultatit numerik te votimit dhe propozimet e miratuara apo te refuzuara. Nëse kërkohet, ne procesverbal duhet te shënohet se si ka votuar secili.

38.17 Procesverbalin nga punimet në mbledhjet e Asamblesë Komunale, Komiteteve, Komisioneve dhe trupave tjera punuese të Kuvendit dhe Ekzekutivit,i mbanë Zyrtari i punësuar për punë të Kuvendit dhe Ekzekutivit.

38.18 Çdokush ka te drejt të merr një kopje te procesverbalit.

38.19 Procesverbalin e nënshkruan Kryesuesi.

38.20 Me Rregulloren për punën e Kuvendit përcaktohet detajisht mënyra e thirrjes , e udhëheqjes së punës dhe e vendosjes në mbledhjet e Kuvendit dhe zëvendësimin e kryesuesit .

Neni 39

Mbledhjet e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës

39.1 Takimi i jashtëzakonshëm i kuvendit të komunës caktohet me kërkesën e bërë me shkrim nga, më së paku, një e treta e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të kuvendit të komunës, apo me kërkesë të kryetarit..

39.2 E drejta për të thirrur një takim të jashtëzakonshëm gjithashtu përfshin të drejtën për caktimin e rendit të ditës për takimin e caktuar.

39.3 Pikat e caktuara në rendin e ditës për mbledhjet e jashtëzakonshme, nuk mund të ndryshohen

gjatë mbledhjes.

39.4 Takimi i jashtëzakonshëm i kuvendit të komunës nuk mbahet nëse të gjithë anëtarët e kuvendit të komunës dhe publiku nuk janë njoftuar me shkrim, siç kërkohet me rregulloret e punës, së paku tri (3) ditë pune para datës së mbajtjes së takimit.

39.5 Procedurat e njëjta që kërkohen për njoftimin dhe çështjet e tjera që zbatohen për mbledhjet e rregullta, zbatohen për mbledhjet e jashtëzakonshme gjithashtu.

39.6 Procedurat e lartpërmendura nuk zbatohen për takimet që thirren për shkak të rrethanave urgjente.

Neni 40

Mbledhjet Publike të Kuvendit

40.1 Mbledhjet publike do të mbahen së paku dy herë në vit në një sallë e cila është e mjaftueshme për pjesëmarrjen e publikut të interesuar. Njëra prej këtyre mbledhjesh do të mbahet në gjashtëmujorin e parë të vitit fiskal, ndërsa tjetra në gjashtëmujorin e dytë.

40.2 Nëse mbahen vetëm dy mbledhje gjatë vitit fiskal, atëherë duhet pasur një interval prej së paku dy muajve ndërmjet.

40.3 Koha, dita dhe vendi ku do të mbahet çdo mbledhje publike do të shpallet përmes tabelës së shpalljeve dhe në forma tjera të informimit publik, së paku dy javë para mbajtjes së mbledhjes.

40.4 Mbledhjet publike nuk do të mbahen në ditë apo kohë që në përgjithësi nuk janë të përshtatshme për publik apo komunitete të caktuara.

40.5 Përfaqësuesit e shtypit do të kenë të drejtë të marrin pjesë në çdo mbledhje publike.

Neni 41

Kryesuesi i Kuvendit, apo përfaqësuesi i tij/saj, do t'i kryesojë mbledhjet publike. Ai/ajo do të ketë autoritetin për ta caktuar procedurën që do të duhet miratuar në mbledhje dhe autoritetin për të mos lejuar diskutimin e çfarëdo çështjeje që nuk ka të bëjë me përgjegjësitë dhe pushtetin e komunës apo kryerjen e punëve komunale. Ai/ajo mund të refuzojnë të thërrasin apo dëgjoj folësit duke prezantuar këndvështrime të ngjashme apo të përsëritura dhe mund të imponoj një limit të përgjithshëm për kohën e lejuar të fjalimeve.

Neni 42

Nëse shtrohet ndonjë pyetje në mbledhjes publike, e në të cilën nuk mund të jepet përgjigja gjatë mbledhjes, organi kompetent apo personi përgjegjës ka obligim që të jap përgjigjen me shkrim brenda 30 ditëve pas mbajtjes së mbledhjes.

Neni 43

Procesverbali i çdo mbledhjes publike do t'i përmbajë detajet e të gjitha informatave të dhëna nga ana e komunës, të gjitha propozimet e parashtruara nga publiku dhe reagim i ndaj tyre si dhe të gjitha pyetjet dhe përgjigjet e dhëna. Një kopje e të gjitha përgjigjeve dhënë me shkrim më vonë, poashtu do t'i bashkëngjitet procesverbalit të mbledhjes.

Neni 44

Komiteti për Politik dhe Financa do t'i shqyrtojë procesverbalet e çdo mbledhjes publike në mbledhjen e parë të radhës pas mbajtjes së mbledhjes. Komiteti do ta analizojë çdo propozim të parashtruar në mbledhje dhe pas kryerjes së konsultimeve të duhura, do të dalë me rekomandim lidhur me propozimin e bërë në mbledhjen e ardhshme të rregullt të Kuvendit Komunal.

Neni 45

Kompensimi

45.1 Kuvendi i Komunës, në pajtim me ligjin, nxjerr vendim për mënyrën dhe lartësinë e kompensimit të punës për anëtarët e Kuvendit, Kryesuesin, si dhe për kryesuesit dhe anëtarët e komiteteve.

45.2 Anëtari i Kuvendit për pjesëmarrje në seancat e Kuvendit si dhe në mbledhjen e komiteteve, lirohet nga obligimet e punës në ndërmarrjen-institucionin ku ka marrëdhënie të rregullt pune.

Neni 46

Komitetet e Kuvendit të Komunës

46.1 Kuvendi i Komunës themelon komitete të përhershme dhe komitete tjera për të cilat konsideron se janë të domosdoshme për kryerjen e përgjegjësisve të Komunës.

46.2 Nëse nuk parashihet ndryshe me ligj, komitetet reflektojnë përbërjen e kuvendit të komunës.

Neni 47

Komitetet e përhershme

Kuvendi i Komunës themelon Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete, si komitete të përhershme.

Neni 48

48.1 Kuvendi Komunal mund të formoj edhe komitete të reja sipas nevojës së paraqitur dhe të vendos për kompetencat dhe veprimtarit e tyre siç janë:

- a)-Komitetin për Shëndetësi dhe mirëqenie sociale,
- b)-Komitetin për Arsim dhe kulturë,
- c)-Komitetin për zhvillim ekonomik,
- ç)-Komitetin për planifikim urban,kadastër dhe ambient,
- d)-Komiteti për sigurinë e bashkësive,

48.2 Përgjegjësit dhe fusheveprimtaria e këtyre komiteteve përcaktohet me rregullore të veçantë të miratuar nga Kuvendi Komunal.

48.3 Kuvendi për shqyrtimin e çështjve të caktuara mund të ngritë edhe Komisione ad hoc,

48.4 Mandati i Komisioneve ad hoc pushon pas zgjidhjes së çështjes.

Neni 49

49.1 Gjatë caktimit të anëtarëve të komiteteve, Kuvendi Komunal duhet të bëjë përpjekje që të sigurojë baraspeshë gjinore dhe të pasqyrojnë në mënyrë sa më të përafërt proporcionin e vendeve që i përmbajnë partitë politike dhe koalicionet në Kuvendin Komunal.

49.2 Përveç Komitetit për Politikë dhe Financa, komitetet tjera mund të kenë në radhët e veta edhe anëtar jashtë përbërjes së Kuvendit, por shumica e anëtarëve duhet të jenë anëtar të Kuvendit Komunal.

49.3 Kryesuesi dhe zëvendeskryesuesi i çdo komiteti zgjidhet nga anëtarët e komitetit përveç në rastet kur me këtë Statut është përcaktuar ndryshe.

49.4 Çdo komitet vendos për kohën e mbajtjes së mbledhjeve në bazë të Rregullores së punës.

49.5 Mbledhja e komitetit konvokohet nëse e shef te nevojshme kryesuesi ose me kërkesën e se paku një te tretës se anëtarëve te komitetit.

Neni 50

Komiteti për Politikë dhe Financa

50.1 Komiteti për politikë dhe financa kryesohet nga kryesuesi i kuvendit të komunës dhe përbërja e tij duhet të reflektojë përfaqësimin e entiteve politike në kuvendi i komunës.

50.2 Komiteti për politikë dhe financa është përgjegjës për:

- shqyrtimin e të gjitha politikave,
- dokumenteve fiskale dhe financiare,
- planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik,
- kornizën vjetore buxhetore afatmesme,
- planin vjetor të prokurimit,
- rregulloren vjetore për tatimet, tarifat dhe pagesat,
- planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal,
- për marrjen e raporteve nga kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në kuvendin e komunës.

Neni 51

Komiteti i komuniteteve

51.1 Komiteti për komunitete përfshinë në radhët e veta shumicën e thjeshtë nga anëtarët e kuvendit të komunës, anëtarët tjerë janë përfaqësuesit e komuniteteve.

51.2 Çdo komunitet që jeton në komunë përfaqësohet nga, së paku një përfaqësues në komitetin për komunitete.

51.3 Përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë në komunë e përbëjnë shumicën e anëtarëve të komitetit të komuniteteve.

51.4 Komiteti i komuniteteve është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së akteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht.

51.5 Komiteti gjithashtu i rekomandon kuvendit të komunës masat që duhet të ndermirren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për t'u avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda komunës.

Kapitulli V

KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJËSITË E KRYETARIT TË KOMUNËS

Neni 52

Kryetari i komunës zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetarët që kanë të drejtë vote në komunë në përputhje me Ligjin mbi zgjedhjet lokale.

Neni 53

Mandati i Kryetarit të komunës zgjatë katër vite.

Neni 54

54.1 Kryetari me rastin e zgjedhjes e jep deklaratën solemne para anëtarëve të Kuvendit Komunal të Deçanit. Teksti i deklaratës është:

“BETOHEM (OSE DEKLAROJ SOLEMNISHT) SE DO TI KRYEJ Detyrat DHE DO TI USHTROI KOMPETENCA TE MIA SI Krye Tar i Komunës së Deçanit me nderë , Besnikëri , Paanshmëri dhe me ndërgjegjeje e në pajtim me ligjin në mënyrë që ti siguroj kushtet për një jetë të qetë për të gjithë”.

54.2 Nëse kryetari i komunës nuk e jap betimin brenda një muaji nga certifikimi i rezultateve të zgjedhjes e humb mandatin.

Neni 55

Kryetari i komunës zbaton përgjegjësit si në vijim:

1. Përfaqëson komunën e Deçanit dhe vepron në emër të saj;
2. Udhëheq ekzekutivin e komunës dhe administratën e saj dhe mbikëqyr administrimin financiar të komunës;
3. Ushtron të gjitha kompetencat, të cilat nuk i jepen në mënyrë eksplicite Kuvendit të Komunës apo komiteteve të tij;
4. Ekzekuton aktet e Kuvendit të Komunës;
5. Emëron dhe shkarkon zëvendësin e tij/saj;
6. Emëron dhe shkarkon Drejtorat e Drejtorateve;
7. Organizon punën dhe drejton politiken e komunës;
8. Propozon rregullore apo akte të tjera për miratim në Kuvendin Komunal;
9. propozon zhvillimin komunal, planet rregullative dhe investuese, propozon buxhetin vjetor për miratim në kuvendin e komunës dhe e ekzekuton buxhetin e miratuar;
10. raporton para kuvendit të komunës për situatën ekonomiko-financiare të komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të komunës, së paku njëherë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga kuvendi i komunës;
11. Mund të kërkojë që Kuvendi Komunal ta rishqyrtoj një akt komunal para hyrjes në fuqi, kur konsideron se akti cenon legjislacionin në fuqi dhe/apo interesin e komuniteteve;
12. Është përgjegjës për t'ia propozuar Kuvendit Komunal Buxhetin vjetor për miratim.
13. I paraqet për shqyrtim komitetit të komuniteteve çdo çështje që ka të bëjë me të drejtat dhe interesat e komuniteteve,
14. Kujdeset për zbatimin e ligjeve dhe akteve tjera,
15. Me ndihmën e Drejtorëve të drejtorateve, Kryetari do të sigurojë që të gjitha organet komunale , Institucionet dhe Ndërmarrjet Publike Komunale të udhëhiqen dhe koordinohen në mënyrë efektive në të gjitha nivelet dhe aspektet,
16. Kryetari mund të propozojë ndryshimin dhe plotësimin e Statutit,
17. I propozon Kuvendit ndryshime në funksionin ose numrin e departamenteve si dhe numrin dhe kushtet e punësimit të anëtarëve në Shërbimin Civil Komunal,
18. bashkëpunon me ndërmarrje dhe institucione vendore e të huaja që nuk i ka në vartësi e që janë në interes për Komunën,
19. Në rast fatkeqësie elementare (zjarr , termet , epidemi etj.) në pajtim me ligjin përkatës, Kryetari shpallë gjendje emergjente dhe në afat prej tri ditësh e njofton Kuvendin për vendimin e marrë, ndërsa Kuvendi për këtë vendos me shumicë votash,

20. Merr Vendime , urdhëresa administrative apo forma të tjera për realizimin e detyrave me interes për Komunën,

21. Kujdeset për realizimin e publicitetit të punës së Kuvendit,

22. I raporton Kuvendit Komunal se paku një herë ne gjashtë muaj.

23. Kryen edhe përgjegjësi tjera të përcaktuara nga Kuvendi i Komunës.

24. Të gjitha kontratat, marrëveshjet dhe dokumentet zyrtare të komunës përveç atyre që me ligje dhe akte tjera i përcaktohen zyrtarëve tjerë, do t' i nënshkruajë Kryetari apo persona me autorizim për të vepruar në emër të tij.

25. Detyrat e veta Kryetari i kryen me ndihmën e Nënkryetarit dhe drejtorëve të drejtorateve.

Neni 56

Mandati i kryetarit të komunës përfundon;

a) kur ta kryejë mandatin e tij;

b) nëse vdes;

c) nëse jep dorëheqje;

d) nëse ndërron vendbanimin në komunë tjetër;

e) nëse nuk paraqitet në punë për më shumë se 1 muaj pa arsye;

ë) nëse shkarkohet nga detyra në pajtim me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe këtë Statut;

f) në rast të vendimit përfundimtar të gjyqit që e privon kryetarin e komunës nga cilësia juridike; dhe

g) në rast të dënimit për vepër penale me një urdhër për burgim për gjashtë (6) muaj ose më tepër.

Neni 57

Largimi i kryetarit

57.1 Qytetarët e komunës mund të ndërmarrin iniciativë për largimin e kryetarit të komunës.

57.2 Kërkesa e tillë duhet të nënshkruhet nga njëzetë (20) përqind e votueseve të regjistruar dhe i dorëzohet kryesuesit të kuvendit të komunës, i cili e paraqet çështjen në institucionin përkatës për administrimin e votimit.

57.3 Nëse shumica e votuesve të regjistruar votojnë për largimin e kryetarit, zgjedhjet e reja për kryetar duhet të bëhen në pajtim me Ligjin mbi zgjedhjet.

Neni 58

Konfliktet e interesit -kryetari

58.1 Menjëherë pas zgjedhjes së tij, kryetari e komunës ndërpret çdo kontratë apo lidhje që ka, e cila mund ta vë në pikëpyetje aftësinë e tij për kryerjen e përgjegjësive të tij/saj në mënyrë të drejtë dhe të pa anshme.

58.2 Kryetari i komunës përjashtohet nga procedurat vendimmarrëse dhe administrative që kanë të bëjnë me ndonjë çështje, në të cilën ai, apo ndonjë anëtar i afërm i familjes së tij, ka interes personal apo financiar.

58.3 Nga kryetari i komunës kërkohet t' i paraqesë konfliktet e interesit sapo të paraqiten ato.

58.4 Kryetari i komunës mundet vullnetarisht ta përjashtojë veten nga vendimmarrja dhe procedurat administrative, nëse konsideron që mund të ketë konflikt të interesit. Kryetari i komunës shënon çdo ndryshim në gjendjen financiare menjëherë pasi që ai të paraqitet.

58.5 Me Rregulloren e punës parashihen masat që duhet të ndërmerren për të përjashtuar kryetarin nga procedurat e vendimmarrjes dhe administrative në rastet kur ka konflikt të interesit.

Neni 59

Nënkryetari i Komunës

59.1 Kryetari i Komunës ka një nënkryetar.

59.2 Nënkryetari emërohet nga kryetari për të njëjtin mandat dhe shkarkohet nga Kryetari.

59.3 Me kërkesë të kryetarit, Nënkryetari i ndihmon kryetarin në ushtrimin e funksioneve ekzekutive të përditshme dhe vepron në emër të Kryetarit në mungesë të tij.

59.4 Kur posti i nënkryetarit mbetet i lirë, kryetari emëron nënkryetarin e ri, jo më vonë se tridhjetë ditë pas paraqitjes së postit të lirë.

59.5 Në raste të konfliktet të interesit të Nënkryetarit zbatohen dispozitat nga neni 58 të këtij Statuti.

Neni 60

Aktet e Kryetarit të Komunës

Kryetari i Komunës nxjerr urdhëresa dhe vendime brenda fushës dhe kompetencave të tij.

Kapitulli VI

ADMINISTRATA KOMUNALE

Neni 61

Organizimi i brendshëm

61.1 Administrata Komunale përbëhet nga Zyra e Kryetarit të Komunës, Drejtoratet Komunale, Zyra e personelit dhe Njësia për Auditimin të brendshëm

61.2 Zyra e Kryetarit të Komunës, Drejtoratet Komunale, Zyra e personelit dhe Auditori i brendshëm ushtrojnë kompetencat nga fushëveprimi i Komunës të përcaktuara me dispozita ligj ore dhe me këtë Statut.

61.3 Në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe të Drejtorateve mund të themelohen sektorët.

61.4 Zyrën e Kryetarit të komunës e udhëheqë Kryetari në mënyrë të drejtpërdrejt, Drejtoratet i udhëheqin drejtorët e emëruar nga Kryetari i Komunës, Sektorët i udhëheqin shefat e sektorëve, ndërsa Zyrën e personelit - Udhëheqësi i personelit.

61.5 Drejtorët udhëheqin drejtoratin e tyre në përputhje me udhëzimet strategjike dhe politike të Kryetarit në pajtim me Ligjin dhe rregulloret komunale në fuqi.

61.6 Drejtorët e drejtorateve i raportojnë rregullisht Kryetarit për çështje që janë nën përgjegjësinë e tyre dhe i ofrojnë të gjitha informatat dhe raportet e nevojshme për procesin e vendimmarrjes.

61.7 Drejtorët mund ti delegojnë përgjegjësit e tyre në pajtim me planin e delegimit të miratuar nga Kryetari dhe Komiteti për Politik dhe Financa.

Neni 62

Zyra e Kryetarit të komunës

62.1 Në zyrën e Kryetarit të Komunës organizohen Sektorët konkret që hyjnë në funksion të mbarëvajtjes së aktiviteteve të Kryetarit.

62.2 Zyra e kryetarit të komunës përbëhet nga:

- Sektori për protokoll,
- Sektori për përfaqësim dhe çështje ligj ore,
- Sektori për marrëdhënie me publikun,
- Sektori pronësor-juridik,
- Sektori për barazi gjinore dhe të drejta të njeriut,
- Zyrtari komunal për integritet evropian,
- Zyrtari komunal për kthim dhe
- Zyrtari certifikues financiar.

Drejtoratet komunale

Neni 63

63.1 Për ushtrimin e funksioneve ekzekutive dhe përgjegjësi të komunës themelohen këto drejtorate:

1. Drejtorati për Administratë
2. Drejtorati për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale,
3. Drejtorati për Arsim dhe Kulturë,
4. Drejtorati për Buxhet dhe Financa,
5. Drejtorati për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit,
6. Drejtorati për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural,
7. Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim,
8. Drejtorati për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike
9. Drejtorati për Inspekcione

63.2 Kuvendi Komunal në kuadër të kompetencave mund të formoi edhe Drejtorate apo zyra të tjera nëse ndihet nevoja për shërbimet e tyre.

63.3 Fushë veprimtaria e secilit Drejtorat komunal, zyre, dhe sektorëve të tyre do të rregullohen me Akt të veçantë të Kuvendit Komunal.

Neni 64

Me vendim të veçantë, Kuvendi Komunal mund të formoi edhe shërbime profesionale administrative brenda Drejtorateve Komunale.

Neni 65

Drejtoratet punën e tyre mund ta organizojnë nëpërmjet shërbimeve dhe sektorëve varësisht nga vëllimi i punëve.

Neni 66

66.1 Drejtorin e secilit Drejtorat e emëron dhe e shkarkon Kryetari i komunës.

66.2 Drejtorët menaxhojnë dhe udhëheqin drejtoratin e tyre në përputhje me udhëzimet strategjike dhe politike të Kryetarit dhe në pajtim me ligjet dhe rregulloret komunale në fuqi dhe janë përgjegjës përveç tjerash:

- a) Për kryerjen efikase të punëve dhe përgjegjësi nga fushëveprimtaria e përcaktuar me dispozita ligjore dhe me këtë Statut,
- b) për organizimin udhëheqjen dhe kontrollin e përditshëm të punës së Drejtoratit dhe të stafit të sistemuar në të,

- c) Përgatisin dhe prezantojnë plane periodike të zhvillimit në sferën e tyre të përgjegjësisë dhe përcjellin realizimin e këtyre planeve,
- ç) Ndihmojnë dhe marrin pjesë në kryerjen e punëve të Kuvendit të Komunës dhe komiteteve të tij dhe Kryetarit të Komunës,
- d) I përgjigjen në mënyrë efektive çfarëdo ankese lidhur me sferën e tyre të përgjegjësisë,
- e) I implementojnë rregulloret dhe vendimet e Kuvendit Komunal, Komiteteve të tij dhe vendimet dhe urdhëresat e Kryetarit të komunës
- f) Sigurojnë informata dhe ndihmë administrative për të gjithë anëtarët e Kuvendit Komunal nga sferat e tyre të përgjegjësisë e që janë të nevojshme për punën e tyre si anëtarë të Kuvendit,
- ë) Sigurojnë ofrimin e një qasje të drejtë e të barabartë për Shërbimet publike që bien në përgjegjësinë e tyre,
- g) Bëjnë vlerësimin e punës të stafit në pajtim me rregullat e Shërbimit civil,
- h) Përbushin të gjitha detyrat dhe urdhëresat që u caktohen nga Kryetari dhe Kuvendi në mënyrë përkatëse dhe të përgjegjshme.
- gj) Kryejnë edhe punë tjera dhe ushtrojnë përgjegjësi nga fushëveprimtaria e drejtoratit.

66.3 Drejtorët i raportojnë rregullisht kryetarit për çështjet që janë nën përgjegjësinë e tyre dhe i ofrojnë atij të gjitha informatat dhe raportet e nevojshme për procesin e vendimmarrjes.

Neni 67

Konflikti i interesit për drejtorët

67.1 Drejtorët përjashtohet nga marrja e vendimeve dhe nga procedurat administrative që kanë të bëjnë me çfarëdo çështjesh për të cilën ai apo ndonjë anëtar i ngushtë i familjes së tij ka ndonjë interes personal ose financiar.

67.2 Nga drejtorët kërkohet që të paraqesin me shkrim çdo konflikt interesash menjëherë pasi shfaqen.

67.3 Rregullorja e punës përcakton masat të cilat merren për të përjashtuar drejtorët nga vendimmarrja dhe procedurat administrative ku ata kanë ndeshje interesash.

Neni 68

Drejtorati për Administratë

68.1 Në kuadër të Drejtoratit për Administratë themelohen sektorët me emërtimet në vijim

1. Sektori për Administratë të Përgjithshme,
2. Sektori për Punë të Kuvendit dhe Komiteteve,
3. Sektori për Gjendjen Civile dhe
4. Sektori për Mirëmbajtje dhe Sigurim të Objekteve.

68.2 Drejtorati për Administratë kryen punët dhe ushtron këto përgjegjësi:

- a) Kryen punët teknike-administrative dhe juridike për përgatitjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës dhe komiteteve të tij,
- b) Bënë pranimin dhe dërgimin e shkresave të organeve dhe kërkesave të palëve të cilat u drejtohen organeve të komunës duke përfshirë dhënien e ndihmës dhe udhëzimeve juridike,
- c) Kryen punët nga lëmi i gjendjes civile,
- ç) Bënë ruajtjen dhe arkivimin e lëndëve të organeve të komunës;
- d) Kryen shërbime të përkthimit dhe

dh) Kryen punët e mirëmbajtjes të objekteve dhe zyrave të punës, teknologjisë informative, të ruajtjes së objekteve të administratës komunale dhe të shërbimeve të transportit për udhëtime zyrtare.

Neni 69

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

69.1 Në kuadër të këtij drejtorati themelohen sektorët me emërtimet në vijim:

1. Sektori për Shëndetësi
2. Sektori për Përkujdesje Sociale

69.2 Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale ushtron përgjegjësitë që i ka komuna sipas dispozitave ligjore nga lëmi i shëndetësisë primare dhe përkujdesjes sociale:

- a) Kryen punët dhe është përgjegjëse për sigurimin e ofrimit të kujdesit parësor shëndetësor si dhe përcjelljen e gjendjes shëndetësore të qytetarëve të komunës,
- b) Kryen punët në zbatimin e kujdesit shëndetësor parësor duke i dhënë përparësi masave parandaluese shëndetësore dhe të realizoi politikat zhvillimore lidhur me planifikimin dhe organizimin nëpërmjet konceptit të mjekësisë familjare,
- c) kujdeset që komuna të realizoi politikat zhvillimore lidhur me planifikimin, organizimin, dhe financimin e kujdesit shëndetësor;
- ç)** Koordinon dhe mbikëqyrë punën e Qendrës kryesore të mjekësisë familjare, qendrave të mjekësisë familjare, ambulancave dhe veprimtarisë private shëndetësore,
- d) Siguron përkujdesje ndaj kategorive të dala nga lufta, familjeve të dëshmorëve, martirëve, invalidëve dhe veteranëve të luftës së UÇK-së,
- dh)** Koordinon dhe mbikëqyrë punën e Qendrës për Punë Sociale,
- e) Përkujdeset për sigurimin e strehimit për të pastrehët,
- ë)** Kryen edhe punë të tjera nga lëmi i mbrojtjes shëndetësore dhe sociale në pajtim me dispozitat ligjore.

Neni 70

Drejtoria për arsim dhe kulturë

70.1 Në kuadër të këtij drejtorati themelohen sektorët me emërtimet në vijim:

1. Sektori për Arsim,
2. Sektori për Kulturë,
3. Sektori për Rini dhe
4. Sektori për Sport.

70.2 Drejtoria për arsim, kulturë, rini dhe sport ushtron përgjegjësitë që i ka Komuna sipas dispozitave ligjore nga lëmi i arsimit, kulturës, rinisë dhe sportit

- a) Planifikon zhvillimin e arsimit në Komunë dhe aftësimin e personelit mësimor, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e arsimit, shkencës dhe teknologjisë,
- b) Nxitë bashkëpunimin e personelit arsimor në raport me nxënësit dhe prindërit,
- c) Siguron mirëmbajtjen dhe riparimin e objekteve shkollore dhe objekteve tjera përcjellëse, **ç)** Bën zgjedhjen e Drejtorit dhe/ose Zëvendës Drejtorit të institucioneve edukativo- arsimore në pajtim me procedurat ligjore për rekrutimin dhe kriteret ligjore të përcaktuara nga MASHT-i nga një komision i caktuar nga Kuvendi Komunal në të cilin dy anëtar do të jenë nga Komuna dhe një nga MASHTI-i;
- d) Menaxhon me objektet komunale të kulturës sportive dhe rinisë,
- dh)** Planifikon dhe organizon aktivitete kulturore, sportive dhe rinore,
- e) Organizon tribuna për zhvillimin e kulturës, sportit dhe rinisë,

- ë) Mban shënime mbi të arriturat kulturore, sportive dhe rinore,
f) Kryen edhe punë tjera nga kompetenca e Komunës nga lëmi i arsimit, kulturës, rinis dhe sporteve.

Neni 71

Drejtorati për buxhet dhe financa,

71.1 Në kuadër të këtij drejtorati themelohen sektorët me emërtimet në vijim:

1. Sektori për buxhet dhe financa,
2. Sektori për tatim në pronë

71.2 Drejtorati për buxhet dhe financa, ushtron përgjegjësitë që i ka Komuna sipas dispozitave ligjore nga lëmi i financave

- a) Bënë përgatitjen e projektit të buxhetit në procedurën e propozimit nga Kryetari i Komunës për miratim në Kuvend;
- b) Është përgjegjëse për mbajtjen e llogarive dhe raporteve financiare periodike dhe vjetore;
- c) Është përgjegjëse për menaxhimin e thesarit;
- ç) Është përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe monitorimin e sistemeve dhe procedurave për ekzekutimin e buxhetit;
- d) Përgatit procedurat dhe raportet e kontabilitetit;
- dh) Ndihmon organet e Komunës në planifikimin e mjeteve buxhetore;
- e) Planifikon, përcakton obligimet në bazë të rregulloreve komunale të subjekteve të caktuara në Komunë, shkallën e ngarkesës (tarifën), nga lëmi i tatimit në pronë, taksave, dhe gjobave Komunale;
- ë) Mbanë evidencën e të hyrave buxhetore nga të hyrat vetanake të Komunës;
- i) Kryen edhe punë tjera nga kompetenca e Komunës në lëmin e buxhetit dhe financave.

Neni 72

Drejtorati për Urbanizëm, kadastrë dhe mbrojtje të mjedisit

72.1 Në kuadër të këtij drejtorati themelohen sektorët me emërtimet në vijim:

1. Sektori për urbanizëm,
2. Sektori për kadastrë dhe gjeodezi
3. Sektori për mbrojtje të mjedisit.

72.2 Drejtorati për urbanizëm, kadastrë dhe mbrojtje të mjedisit ushtron përgjegjësitë që i ka Komuna sipas dispozitave ligjore nga lëmi i urbanizmit, kadastrit dhe mbrojtjes së mjedisit, si vijon:

- a) Harton planin e zhvillimit hapësinor, urbanistik dhe rural të Komunës,
- b) Vendosë sipas kërkesave për dhënie të lejave të ndërtimit,
- c) Harton kriteret për dhënie me qira të objekteve komunale dhe tokës ndërtimore të Komunës,
- ç) Mban evidencën për emërtimet e vendbanimeve, rrugëve, shesheve si dhe numrat e objekteve dhe shtëpive brenda territorit të Komunës,
- d) Bënë vlerësimin e pronës sipas kriterëve dhe standardeve të caktuara me legjislacionin në fuqi,
- dh) Mban regjistrin e pronës së paluajtshme dhe regjistrin e tokës komunale,
- e) Mban evidencat dhe hartat kadastrale për tokën dhe ndërtesat në territorin e Komunës,

ë) Bënë matjet kadastrale, regjistron të dhënat kadastrale dhe lëshon dokumentet përkatëse sipas kërkesave të palëve,

I) Kujdeset për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e mjedisit, dhe

g) Kryen edhe punë tjera nga kompetenca e Komunës në lëmin e urbanizmit, kadastrit dhe mbrojtjes së mjedisit.

Neni 73

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim rural

73.1 Në kuadër të këtij drejtorati themelohen sektorët me emërtimet në vijim:

1. Sektori për bujqësi,

2. Sektori për pylltari.

3. Sektori për menaxhim me ujëra për ujitje.

73.2 Drejtoria kryen punët dhe ushtron përgjegjësitë që i ka Komuna sipas dispozitave ligjore nga lëmi i bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural, si vijon:

a) Ndërmerr masa të planifikimit dhe masa tjera që ndikojnë në përparimin e bujqësisë,

b) Kujdeset të sigurojë që toka bujqësore të shfrytëzohet për prodhimtari bujqësore,

c) Me qëllim të ruajtjes dhe mbrojtjes së potencialit bujqësor në mënyrë të përhershme, duke u bazuar në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të Komunës, kujdeset të përcaktohet shfrytëzimi, mbrojtja, rregullimi dhe qiradhënia e tokës bujqësore,

ç) Kujdeset që toka bujqësore e cila është shfrytëzuar për destinime tjera e cila nuk ka karakter të përhershëm, t'i kthehet destinimit të parë, përkatësisht të aftësohet për prodhimtari bujqësore sipas projekteve për rikultivim,

d) Ndërmerr masa të planifikimit dhe masa për mbrojtjen dhe ruajtjen e fondit të pyjeve,

dh) Kryen edhe punë tjera nga kompetenca e Komunës nga lëmi i bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural.

Neni 74

Drejtoria për Ekonomi dhe zhvillim

74.1 Në kuadër të këtij drejtorati themelohen sektorët me emërtimet në vijim:

1. Sektori për planifikim,

2. Sektori për zhvillim ekonomik

3. Sektori për turizëm

74.2 Drejtoria kryen punët dhe ushtron përgjegjësitë që i ka Komuna sipas dispozitave ligjore nga lëmi i zhvillimit ekonomik dhe turizmit si vijon:

a) Harton projektin e planit strategjik dhe zhvillimor të Komunës;

b) Harton plane për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të Komunës;

c) Harton plane për shfrytëzimin e burimeve ekonomike brenda Komunës;

ç) Krijon kushte të qëndrueshme për zhvillimin e ndërmarrjave të vogla dhe të mesme;

d) Harton planin strategjik të zhvillimit të turizmit në harmoni me planin global strategjik të zhvillimit ekonomik të komunës,

dh) Në harmoni me Ligjin për veprimtaritë hoteliere dhe turistike bën promovimin e turizmit brenda territorit të komunës,

ë) Kryen edhe punë tjera nga kompetenca e Komunës nga lëmi i zhvillimit ekonomik.

Neni 75

Drejtoria për mbrojtje, shpëtim dhe shërbime publike

75.1 Në kuadër të këtij drejtorati themelohen sektorët me emërtimet në vijim:

1. Sektori pambrojtje dhe shpëtim,
2. Sektori për shërbime publike,
3. Sektori për rrugë lokale dhe transport lokal
4. Sektori për menaxhim të projekteve.

75.2 Drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim kryen punët dhe ushtron përgjegjësitë që i ka Komuna sipas dispozitave ligjore nga lëmi e mbrojtjes dhe shpëtimit si dhe ligjeve dhe rregulloreve me të cilat rregullohen shërbimet publike komunale

a) Kujdeset, planifikon dhe mbikëqyrë masat e ndërmarra për mbrojtje nga zjarri dhe fatkeqësitë natyrore,

b) Ofron shërbimet e zjarrfikësve dhe të emergjencës për ofrimin e mbrojtjes dhe të ndihmës nga fatkeqësitë elementare,

c) Në sferën e emergjencës bashkëpunon me organizatat joqeveritare -institucionet shëndetësore, lokalitetet urbane dhe rurale në rastet e zjarreve, vërshimeve, tërmetev e dhe fatkeqësive tjera elementare,

ç) Kryen edhe punë tjera nga kompetenca e Komunës nga lëmi e mbrojtjes dhe shpëtimit.

d) Kujdeset dhe monitoron funksionimin e furnizimit me ujë të pijshëm, me rrymë elektrike, funksionimin e rrjetit të kanalizimit dhe ndriçimit publik;

dh) Kujdeset dhe monitoron funksionimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve, trotuareve, sipërfaqeve të gjelbëruara, të shfrytëzimit të sipërfaqeve të lira publike në pronësi të Komunës, të vendosjes së panove dhe reklamave, të parkingjeve dhe të mirëmbajtjes së varrezave,

e) Kujdeset dhe monitoron mirëmbajtjen e pastërtisë dhe rregullimit të qytetit dhe të vendbanimeve;

ë) Propozon çështjet përkitazi me rregullimin e transportit urban dhe autotaksi të udhëtarëve;

I) Kujdeset dhe monitoron funksionimin e tregjeve;

g) Menaxhon projektet komunale, dhe

kryen edhe punë tjera nga kompetenca e Komunës në lëmin e mbrojtjes, shpëtimit dhe shërbimeve publike.

Neni 76

Drejtoria për inspeksion

Drejtoria për inspeksion kryen punët dhe ushtron përgjegjësitë që i ka Komuna sipas dispozitave ligjore të mbikëqyrjes, në kuadër të së cilës funksionojnë inspeksionet, si vijon: i tregut, sanitar, i mjedisit dhe ambientit, i trafikut, i ndërtimtarisë, i bujqësisë dhe inspeksionet tjera komunale të përcaktuara me ligj.

Zyra e Komuniteteve

Neni 77.

77.1 Me qëllim të përmirësimit të mbrojtjes dhe të sigurimit të shërbimeve të barabarta publike në nivel komunal themelohet Zyra e Komunitetit.

77.2 Zyra e Komunitetit është pjesë integrale e komunës dhe e strukturës së përbashkët administrative e cila financohet nga buxheti komunal.

77.3 Shefi i Zyrës së Komunitetit i dërgon raport me shkrim Komitetit të Komuniteteve për secilën mbledhje, duke përshkruar në detaje punët e kryera për të cilat është përgjegjës ajo Zyre e Komunitetit

77.4 Pushteti Qendror e shqyrton rregullisht nevojën e ekzistimit të çdo Zyreje apo nën Zyreje të Komunitetit.

77.5 Personeli i Zyrës së Komunitetit gëzon të njëjtin status të personelit të Shërbimit Civil komunal.

Kapitulli VII SHËRBIMI CIVIL KOMUNAL

Neni 78

Shërbyesit civil

Shërbimi civil komunal përfshinë të gjithë personat e punësuar nga autoriteti komunal, rroga e të cilëve paguhet nga buxheti i Republikës së Kosovës, përveç:

- a) Kryetarit, nënkryetarit/ve dhe drejtorëve komunal,
- b) Kryesuesit, zëvendëkryesuesit/ve dhe të gjithë anëtarëve të kuvendit të komunës.

Neni 79

Udhëheqja

Shërbimi civil komunal udhëhiqet në bazë të parimeve dhe procedurave të përcaktuar me legjislacionin në fuqi. Me rastin e rekrutimit të personelit të Komunës duhet respektuar procedurat e hapura dhe konkurruese për të pranuar shërbyes civil të Komunës me kualitet të lartë, në bazë të meritave dhe kompetencave.

Neni 80

Udhëheqësi i personelit

80.1 Administrata komunale ka udhëheqësin e personelit.

80.2 Kryetari shpall, rekruton dhe e largon posti udhëheqësin e personelit në pajtim me ligjin e aplikueshëm mbi shërbimin civil.

80.3 Nëse posti i udhëheqësit të personelit mbetet i zbrazët, kryetari i komunës emëron një anëtar të lartë të shërbimit civil komunal në cilësinë e kryesit të detyrës së udhëheqësit të personelit.

80.4 Brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh, kryetari rekruton udhëheqësin e personelit.

Neni 81

Konfliktet e interesit

Nëpunësi i administratës komunale përjashtohet nga vendimmarrja dhe procedurat administrative lidhur me ndonjë çështje në të cilën ai apo ajo, ose ndonjë anëtar i afërm i familjes së tij, ka interes personal ose financiar.

Neni 82

Punësimi

82.1 Numri i personelit që duhet emëruar dhe angazhuar në çdo Drejtorat për kryerjen e punëve, detyrave dhe veprimtarisë së rregullt të drejtoratit dhe gradat e tyre do të përcaktohen nga Kuvendi

Komunal me rekomandimin e Komitetit për Politik dhe Financa shefit te personelit ne mbledhjen e par te vitit fiskal.

82.2 Punësimi në shërbimin civil komunal duhet të mbikëqyret dhe rregullohet nga udhëheqësi i personelit për të siguruar që shërbimi civil reflekton proporcion të drejtë profesional, gjinor dhe etnik.

82.3 Shërbimi Civil Komunal si tërësi duhet që të përmbajë proporcion të drejtë të përfaqësimit të personave me aftësi të kufizuara.

82.4 Nënpunësit në Shërbimin Civil Komunal rekrutohen përmes konkursit publik.

82.5 Kushtet dhe procedurat si dhe konflikti i interesave të personelit administrativ janë të përcaktuara me dispozita ligjore.

Kapitulli VIII **TRANSPARENCA, KONSULTIMET ME PUBLIKUN DHE MEKANIZMAT E** **PJESËMARRJES SË QYTETARËVE**

Neni 83

Transparenca

83.1 Ne te gjitha mbledhjet e Kuvendit Komunal dhe komiteteve te tij lejohet pjesëmarrja e publikut duke përfshi edhe përfaqësuesit e shtypit.

83.2 Çdo anëtar i publikut që merr pjesë në ndonjë mbledhje të Kuvendit të Komunës apo të ndonjërit prej komiteteve të tij, mund, me lejen e kryetarit, të shtroj pyetje dhe t'i drejtohet mbledhjes. Rregullat e Procedurës mund ta rregullojnë mënyrën se si realizohet kjo e drejtë dhe liria e kryetarit për të zgjedhur.

83.3 Kuvendi i Komunës dhe komitetet e tij, mund të vendosin për mospjesëmarrje të publikut në mbledhje ose një pjesë e sajë, duke përfshirë edhe përfaqësuesit e mediave, në rastet kur natyra e çështjeve që shqyrtohen mund të marrë përmasa të dëmshme për interes të përgjithshëm publik.

83.4 Personat e interesuar mund të kërkojnë shikimin, përkatësisht kopjen e dokumenteve të Komunës në pajtim me procedurat e ligjit mbi qasjen në dokumentet zyrtare.

83.5 Dokumentet që janë për shikim do të lëshohen konform ligjit për qasje në dokumente zyrtare, pas pranimit të kërkesës, gjatë orarit të punës dhe në vendin ku ato mbahen. Personi që dëshiron ta shikoj një dokument duhet të tregojë të dhëna të mjaftueshme në mënyrë që të mundësohet identifikimi i dokumentit dhe varësisht nga kërkesa, atij do t'i tregohet vendi ku mund ta gjejë dokumentin.

83.6 Personi që inspekton dokumentin do të ketë mundësi ta bëjë një kopje të dokumentit për shfrytëzimin e vet. Komuna mund ta lëshojë një kopje dhe të kërkojë një tarifë që nuk tejkalon çmimin e kopjes.

83.7 Nëse një person dëshmon se dokumenti të cilin mbanë komuna përmban informata të gabueshme, ai/ajo do të ketë të drejtë të kërkojë që ato informata të përmirësohen falas, nga departamenti përkatës.

83.8 Komuna themelon organin e informimit përmes të cilit bënë publikimin rregullativës, aktiviteteve si dhe të arriturave nga lëmi të ndryshme.

83.9 Të gjitha letrat dhe kumtesat zyrtare që i lëshon komuna do të kenë emrin, titullin, adresën dhe numrin e telefonit të personit që i ka lëshuar ato dhe që mund të ofrojë informata më të hollësishme lidhur me çështjen në fjalë.

Neni 84

Konsultimet dhe pjesëmarrja e publikut

84.1 Kryetari dhe të gjitha komitetet në kuadër të Kuvendit të Komunës do të kenë autoritetin për të caktuar konsultim dhe pjesëmarrje publike për çdo çështje brenda kompetencave të tyre.

84.2 Në takime publike përfaqësuesit komunal informojnë pjesëmarrësit për aktivitetet e komunës, kurse pjesëmarrësit mund të shtrojnë pyetje dhe të japin propozime për përfaqësuesit e zgjedhur komunal.

84.3 Përveç takimeve publike, komuna është e obliguar t'i informojnë qytetarët e komunës për çfarëdo planesh apo programesh të rëndësishme me interes publik, siç rregullohet me aktet e komunës.

84.4 Kuvendi i komunës miraton rregulloren komunale që promovon transparencë të organeve legislative, ekzekutive dhe administrative të komunës, duke e rritur pjesëmarrjen e publikut në marrjen e vendimeve në nivel lokal dhe duke lehtësuar qasjen publike në dokumentet zyrtare të komunës.

84.5 Çdo person mund të shikojë çfarëdo dokumenti që mbahet nga komuna, përveç nëse zbulimi i tillë nuk është i ndaluar sipas Ligjit mbi qasjen në dokumentet zyrtare.

84.6 Informatat që i takojnë kategorive të ndaluara sipas ligjit për qasje në dokumentet zyrtare, do të epn vetën në kushte sipas të cilave ndalohet përhapja e tyre e mëtejme. **84.7** Arsyet për masat e këtilla do t'i bëhen me dije anëtarit dhe do të shënohen në dosje.

84.8 Komuna me rastin e marrjes së vendimeve dhe miratimit të rregulloreve nga kompetenca e vet, paraprakisht do të konsultoj publikun, në mënyrë që të merren parasysh sugjerimet dhe propozimet e publikut.

84.9 Komuna shfrytëzon format e konsultimit të publikut, si vijon:

- a) Publikimi i projekteve të akteve dhe rregulloreve në organin e informimit të Komunës, në tabelën e shpalljve dhe në Ueb-faqen e Komunës,
- b) Organizimi i konsultave me publikun-grupeve të interesuara për të cilat ka të bëjë çështja e caktuar para se të miratohen në Kuvend dhe
- c) Organizimi i tryezave dhe anketave me qytetarë.

Neni 85

Mekanizmat e pjesëmarrjes së qytetarëve

Qytetarët e komunës dhe subjektet tjera, i realizojnë të drejtat e tyre të demokracisë të drejtpërdrejtë nëpërmes të formave të prezantimit të peticionit, të ndërmarrjes së iniciativave të qytetarëve kërkesës për mbajtjen e referendumit, si dhe iniciativave të tjera, për çështjet të cilat janë në interes të qytetarëve nga përgjegjësitë dhe kompetenca e komunës.

Neni 86

Peticionet

Çdo person apo organizatë që ka interes në komunë, ka të drejtë të paraqes peticion Kuvendit Komunal për çfarëdo çështje që ka të bëjë me përgjegjësitë dhe kompetencat e komunës.

Neni 87

87.1 Të gjitha peticionet duhet t'i drejtohen Kuvendit të Komunës dhe t'i dërgohen Kryesuesit të Kuvendit Komunal.

87.2 Kuvendi i Komunës nuk do të përfillë asnjë peticion që ka të bëjë me çështje jashtë përgjegjësisë dhe kompetencave të komunës.

Neni 88

Çdo peticion duhet të përmbajë emrin dhe adresën e organizatorit(ëve) dhe emrat dhe adresat e personave që e nënshkruajnë. Lënda e peticionit duhet të shënohet qartë në çdo faqe të peticionit.

Neni 89

Kryesuesi i Kuvendit Komunal do ta prezantojë çdo peticion të vlefshëm para Kuvendit të Komunës brenda 30 ditëve nga dita që ai/ajo pranon, apo në takimin e ardhshëm të Kuvendit Komunal nëse është më vonë. Kuvendi Komunal mund t'ia referojë peticionin komitetit përkatës të Kuvendit për shqyrtim të mëtejshëm. Organizatori(ët) i peticionit do të ketë të drejtë t'i drejtohet pjesëmarrësve të çdo mbledhjeje ku shqyrtohet peticioni.

Neni 90

Kuvendi i Komunës do ta merë vendimin përfundimtar lidhur me lëndën e peticionit më së largu dy muaj pasi të bëhet prezantimi i peticionit në Kuvend. Vendimi do të arsyetohet dhe do t'i kumtohet së bashku me arsyetim organizatorit(ëve) të peticionit.

Neni 91

Referendumi

91.1 Për disa çështje me interes të përgjithshëm, që kanë të bëjnë me kompetencat e komunës, për të cilat Kuvendi Komunal për arsye të ndryshme nuk merr vendim përfundimtar, atëherë organizon referendum.

91.2 Organizimi i kësaj forme të deklarimit të qytetarëve bëhet konform dispozitave ligjore në fuqi.

91.3 Qytetarët e Komunës mund të kërkojnë që një rregullore e Kuvendit të komunës të miratuar nga Kuvendi i komunës, t'i nënshtrohet referendumit.

91.4 Kërkesa duhet t'i dorëzohet kryesuesit të kuvendit të komunës, brenda 30 ditësh nga data e miratimit të rregullores e cila duhet të nënshkruhet nga 10% e votuesve të regjistruar.

91.5 Kuvendi i komunës duhet ta shqyrtojë kërkesën brenda 30 ditësh pas pranimit të peticionit, në pajtim me ligjin në fuqi.

Iniciativa e qytetarëve

Neni 92

92.1 Qytetarët mund të marrin iniciativë për të propozuar rregullore, brenda kompetencave të komunës, për miratim nga kuvendi apo me votën e qytetarëve, në pajtim me ligjin në zbatim.

92.2 Propozuesit ia dorëzojnë draftin e rregullores së propozuar kryesuesit të kuvendit të komunës.

92.3 Draft rregullorja e propozuar duhet të nënshkruhet nga 15% e votuesve të regjistruar për t'u shqyrtuar nga kuvendi i komunës.

92.4 Kuvendi i komunës është i obliguar ta shqyrtojë rregullorën e propozuar brenda 60 ditësh pas pranimit.

Neni 93

Ankesat e qytetarëve kundër një akti administrativ të organeve komunave shqyrtohen sipas ligjit për procedurën administrative.

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Neni 94

Për të gjitha çështjet të cilat nuk janë rregulluar shprehimisht me këtë Statut apo në rast konflikti ose dykuptimësie do të zbatohen ligjet si dhe aktet e pushtetit qendror.

Neni 95

Propozimin për të ju qasë ndryshimeve në Statutin e Komunës mund ta paraqesin çdo anëtarë i Asamblesë , Komitet, dhe çdo individ tjetër nga shoqëria civile. Propozimi me shkrim duhet ti paraqitet Kryesuesit të Komunës

Neni 96

Procedura për përmirësimin e Statutit Komunal do të jetë si vijon:

1. Çdo propozim për të përmirësuar Statutin Komunal duhet të aprovohet nga ana e Komitetit Politik dhe Financiar.
2. Propozimi më pas do t'i dërgohet Kuvendit Komunal për shqyrtim preliminar. Nëse Kuvendi nuk e refuzon propozimin, Kuvendi do të ndërmer masa të konsultimit publik në lidhje me propozimin.
3. Pas përfundimit të konsultimit publik, Kuvendi i Komunës do të vendose se a do t'i miratojë përmirësimet, me apo pa modifikime, pasi ti konsiderojë të gjitha prezantimet që ka pranuar.

Neni 97

97.1 Vendimi për miratimin apo ndryshimin e Statutit miratohet më 2/3 e anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

97.2 Vendimi për miratimin e Rregulloren së punës, apo për ndryshimin e saj nëse është e nevojshme bëhet me votimin e shumicës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

Neni 98

Me hyrjen në fuqi të këtij Statuti pushon të vlej Statuti komunal 01 .Nr.303 i datës 31.10.2008

Neni 99

Pas aprovimit të këtij Statuti të gjitha rregulloret komunale dhe aktet tjera duhet të harmonizohen me të brenda gjashtë muajve.

Neni 100

Statuti hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Deçanit.

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

01.Nr.V-2
Deçan, dt.04.05.2010

Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Jashar DOBRAJ